

PRISHTINA



Komuna e Prishtinës

Opština Priština –Municipality of Prishtina

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT
PRISHTINË

RAPORT

SUKSESI DHE REZULTATI I NXËNËSVE I ARRITUR NË TRI NIVELET
E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR GJATË VITIT SHKOLLOR

2015/16



Prishtinë, 2016

Përmbajtja:

Hyrje.....	3
------------	---

Bashkëpunim, mbështetje dhe mbikëqyrje të vazhdueshme institucioneve edukativo-arsimore në funksion të ngritjes së cilësisë në arsim.....04

<i>Suksesi në nivelin e arsimit fillor (I-V).....</i>	<i>06</i>
<i>Suksesi i nxënësve të arritur për secilën lëndë.....</i>	<i>07</i>
<i>Realizimi i orëve të planifikuar për nivelin e parë të arsimit.....</i>	<i>08</i>
<i>Vijueshmëria e nxënësve.....</i>	<i>08</i>
<i>Suksesi në nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX).....</i>	<i>10</i>
<i>Suksesi i nxënësve të arritur për secilën lëndë.....</i>	<i>10</i>
<i>Rezultatet e Testit të Arritshmërisë.....</i>	<i>12</i>
<i>Realizimi i orëve të planifikuar për nivelin e dytë të arsimit.....</i>	<i>14</i>
<i>Vijueshmëria e nxënësve.....</i>	<i>15</i>
<i>Mungesat e mësimdhënësve të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët (I-IX).....</i>	<i>16</i>
<i>Suksesi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë (X-XII).....</i>	<i>17</i>
<i>Rezultatet e nxënësve të nivelit të mesëm të lartë, të arritur në lëndët e përgjithshme.....</i>	<i>18</i>
<i>Rezultatet e provimit shtetëror të maturës.....</i>	<i>19</i>
<i>Realizimi i orëve të planifikuar për nivelin e tretë të arsimit.....</i>	<i>23</i>
<i>Vijueshmëria e nxënësve.....</i>	<i>23</i>
<i>Mungesat e mësimdhënësve (X-XII).....</i>	<i>24</i>
<i>Tabelat e suksesit për të tri nivelet e arsimit parauniversitar.....</i>	<i>25</i>
<i>Përfundimi.....</i>	<i>33</i>
<i>Rekomandimet.....</i>	<i>36</i>

Hyrje

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në çdo fundvit shkollor bënë një vlerësim dhe analizë të përgjithshme, për ecurinë dhe performancën e procesit edukativo-arsimor dhe analizon suksesin e nxënësve për rezultatet e arritura, për të tri nivelet e arsimit parauniversitar, duke krahasuar rezultatet e suksesit me rezultatet e periudhës së njëjtë të vitit paraprak.

Në raport me vitet paraprake, këtë vit Drejtoria e Arsimit ka realizuar një plan dinamik, duke e përcjellur nga afër ecurinë e procesit arsimor, duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale nga zyrtarët e arsimit, duke bashkëpunuar me institucionet dhe organizata të ndryshme për zhvillimin profesional të mësimit dhe sigurimin e efikasitetit të procesit të mësimit dhe mësimit dhe njëkohësisht ka realizuar aktivitete dhe gara të shumta në funksion të ngritjes dhe përmirësimit të cilësisë në arsim.

Po ashtu edhe këtë vit shkollor janë vlerësuar dhe analizuar rezultatet e testeve të jashtme: Testit të Arritshmërisë dhe Provimit Shtetëror të Maturës, duke i krahasuar me rezultatet e vlerësimit të brendshëm.

Duke ditur se vlerësimi është një proces dhe indikator determinues për nxjerrjen e treguesve kryesor, për ngritjen e cilësisë në arsim dhe për krijimin e një sistemi arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme - shoqërisë së dijes, kjo analizë bëhet jo vetëm për të konstatuar gjendjen, por edhe për të përcaktuar objektivat për të ardhmen, që do të reflektojnë pozitivisht në përmirësimin e shkallës së arritshmërisë së nxënësve dhe ngritjen e cilësisë së mësimit në procesin edukativo-arsimor.

Drejtoria Komunale e Arsimit po punon në mënyrë të vazhdueshme, për krijimin e kushteve më të mira me qëllim që cilësia dhe rezultatet e suksesit në shkollat tona të shënojë progres dhe të arrijnë në nivelin e shkollave të përparuara, si: në mësimit, në mësimit dhe të një vlerësimi sa më objektiv të arritshmërisë së nxënësve.

BASHKËPUNIM, MBËSHTETJE DHE MBIKËQYRJE TË VAZHDUESHME INSTITUCIONEVE ARSIMORE NË FUNKSION TË NGRITJES SË CILËSISË NË ARSIM

Drejtoria e Arsimit, në funksion të realizimit të punëve dhe detyrave me përgjegjësi, zhvillimit dhe përmirësimit të cilësisë në arsim, në shkollat e Komunës së Prishtinës, gjatë vitit shkollor 2015/16, ka realizuar në mënyrë sistematike vizita në të gjitha institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar. Vizitat kishin karakter mbështetës, kontrollues dhe këshillues për drejtuesit e institucioneve dhe stafin mësimdhënës.

Për të përmirësuar cilësinë në arsim dhe për t'i nxjerrë në pah shkathtësitë dhe kompetencat e nxënësve të arritura në shkencat natyrore-shoqërore dhe mbështetjen e tyre drejt avancimit dhe zhvillimit profesional, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, ka organizuar gara të ndryshme në këtë vit shkollor si: "Olimpiadën Matematike", "Olimpiadën Kombëtare të Kosovës në Kimi", "Shkencëtarin e Ri", "Garat e Diturisë – Prishtina 2016", garën për "Esenë më të mirë", garën për "Poezinë më të mirë" dhe garën për "Pikturën më të mirë" me nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar.

Po ashtu, në funksion të përmirësimit të cilësisë në arsim dhe ngritjes së rezultateve të nxënësve, Drejtoria e Arsimit nga tetori i vitit 2015, ka filluar implementimin e mësimin me qëndrim tërëditor, në tri institucione edukativo-arsimore të nivelit të arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, në: SHFMU "Faik Konica", SHFMU "Model" dhe SHFMU "Afrim Gashi". Qëllimi dhe objektivat e mësimin tërëditor janë lexim-shkrim/kuptueshmëri (fusha e gjuhëve dhe komunikimit) dhe edukatë fizike, duke përmirësuar arritshmërinë e nxënësve në gjuhën e parë, duke përmirësuar të folurit, të shkruarit dhe komunikimin si dhe të ju ndihmojë nxënësve të kenë një trup të shëndoshë përmes aktiviteteve fizike.

Organizimi i mësimin në formë të tillë ka reflektuar drejtpërsëdrejti në ngritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Drejtoria e Arsimit, duke parë inovacionet e hovshme të zhvillimit të shoqërisë bashkëkohore, ka ndërmarrë të gjitha veprimet konkrete që të zgjerohet veprimtaria edukativo-arsimore e shkollës, njëherit edhe roli dhe funksioni i saj pedagogjik dhe social.

Shkollat pilot, nuk kanë pasur vetëm objekt pune mësimin e rregullt, por edhe format e tjera organizative edukativo-arsimore jashtëmësimore me ndihmën e të cilave ndihmon zhvillimin e personalitetit të nxënësve sipas aftësive psikofizike të tyre.

Studimet pedagogjike si dhe të arriturat shkencore të psikologjisë zhvillimore kanë vërtetuar se nxënësit dallohen ndërmjet veti për nga shkalla e cilësisë së aftësive psikofizike, pra për nxënësit që përparojnë me vështirësi shkollat organizuan mësim plotësues, ndërsa për nxënësit talent organizuan mësim shtues.

Është indikativ fakti, se mësimi me orar tërëditor është një ndër faktorët determinues për përmirësimin dhe ngritjen e standardit të cilësisë në arsim dhe për krijimin e një

sistemit arsimor bashkëkohor në përputhje me kërkesat e shoqërisë së sotme - shoqërisë së dijes.

Qëndrimi tërëditor në shkollë presim të ndikoj edhe në aspektin ekonomik. Nxënësit, që kanë vështirësi të natyrës materiale, sociale dhe shëndetësore, duke qëndruar në shkollë kanë marrë ndihmën e organizuar pedagogjike dhe kanë shënuar progres në mësim. Kjo formë e organizimit ka reflektuar edhe në zvogëlimin e numrit të përsëritësve si dhe shpenzimet e prindërve. Kështu që, organizimi i mësimit tërëditor në shkollë duhet kuptuar dhe duhet organizuar si masë preventive kundër rekrutimit të delikuinteve të rinj.

Organizimi i mësimit në formë të tillë, përveç përparësive që reflektoj tek cilësia e mësimnxënies, po ashtu, ka reflektuar edhe të puna e mësimdhënësve, sepse janë krijuar kushte dhe mundësi më të mira për të shprehur potencialin e tyre intelektual dhe për të arritur objektivat që synojnë.

Në vijim prezantojmë suksesin e shkollave ku është zhvilluar mësimi tërëditor 2015/16, duke e krahasuar me suksesin e vitit shkollor 2014/15, ku mësimi zhvillohej me orar gjysmëditor:



Graf. 1. Pasqyron suksesin të shkollave ku zhvillohet mësimi me qëndrim tërëditor (I-IX).

Po ashtu, Drejtoria e Arsimit në zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në arsim ka ndërmarrë veprime konkrete në shumë dimensione që garantojnë progres në ngritje të cilësisë, duke përmirësuar infrastrukturën shkollore, pajisjen e shkollave me kabinate, laboratorë, me biblioteka shkollore, me rekuizita sportive dhe mjete të ndryshme, organizimin e vazhdueshme të trajnimeve të ndryshme në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe organizata joqeveritare, për ngritjen dhe zhvillimin profesional të mësimdhënësve, në mënyrë që të kemi një mësimdhënie cilësore dhe të jemi në hapë me trendët ndërkombëtare.

SUKSESI NË NIVELIN E ARSIMIT FILLOR-(I-V)

Në Komunën e Prishtinës, procesi edukativo-arsimor zhvillohet në **43** shkolla fillore dhe të mesme të ulëta, dhe **18** paralele të ndara fizike. Në këto shkolla mësimin në vitin shkollor **2015/16**, e kanë vijuar **30997** nxënës, të shpërndarë në **1298** paralele, që i bie mesatarisht **23,88** nxënës për paralele.


Nëse shohim vijueshmërinë sipas klasave kemi këtë pasqyrë:

- Në nivelin e arsimit fillor, **I-V**, kanë vijuar **16892** nxënës, të shpërndarë në **730** paralele, mesatarisht **23,13** nxënës për paralele, ndërsa në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, **VI-IX**, gjithsej **14105** nxënës, të shpërndarë në **568** paralele, mesatarisht **24,83** nxënës për paralele. Në këtë numër të përgjithshëm të nxënësve nuk janë përfshirë **2202** nxënës të nivelit parafillor.

Vlen të theksohet se mesatarja e numrit të nxënësve për paralele **23,13** të nivelit fillor dhe **24,83** të niveli i mesëm i ulët, është pasojë e numrit jashtëzakonisht të vogël të nxënësve në shkollat e vendbanimeve rurale të Komunës së Prishtinës, në të cilat shkolla kemi hapësirë të madhe shkollore në krahasim me numrin e nxënësve. E kundërt është gjendja në shkollat e qytetit, ku kemi numër të madh të nxënësve dhe hapësirë jo të mjaftueshme shkollore.

-Suksesi i arritur i nxënësve në nivelin fillor të arsimit, është si më poshtë: **16865** nxënës me sukses pozitiv apo **99.84**-përqind, **9** me sukses të pamjaftueshëm, **0.053**-përqind dhe **18** nxënës të panotuar, **0.10**-përqind, Suksesi sipas vlerësimit të përgjithshëm përfundimtar është:

- ⇒ me sukses të shkëlqyeshëm **13284** nxënës, ose **78.64**-përqind
- ⇒ me sukses shumë të mirë **2280** nxënës, ose **13.50**-përqind
- ⇒ me sukses të mirë **1057** nxënës, ose **6.26**-përqind
- ⇒ me sukses të mjaftueshëm **244** nxënës, ose **1.44**-përqind
- ⇒ me sukses pamjaftueshëm gjithsej **9** nxënës, ose **0.11**-përqind
- ⇒ të panotuar **18** nxënës, ose **0.10**-përqind



Graf. 2. Pasqyron suksesin e nxënësve të nivelit fillor (I-V).

Është indikativ fakti, se vlerësimi si proces vazhdon të jetë sfidues për sistemin e arsimit të Republikës së Kosovë, ku në bazë të statistikave dhe të dhënave të

analizuara, konsiderojmë se në këtë nivel të arsimit fillor (I-V), akoma nuk është arritur një standardizim i plotë dhe unik sa i përket procesit të vlerësimit, e për këtë dëshmon edhe nota mesatare **4.53**, në raport me vitin paraprak kemi ngritje të suksesit prej 0.05-përqind.


Po ashtu, pas analizës dhe vlerësimit të suksesit dhe rezultateve të brendshme në krahasim me rezultatet e vlerësimit të jashtëm, arrijmë në përfundim se ka dallime në vlerësim.

Suksesi i arritur për secilën lëndë

Për të konstatuar ecurinë dhe zhvillimin e arsimit në shkollat e kryeqendrës, Drejtoria e Arsimit në fund të vitit shkollor 2015/16, ka realizuar një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm suksesit dhe rezultateve të nxënësve të arritura në secilën lëndë, duke krahasuar edhe me rezultatet e vitit që lamë pas.

Nr	Lënda	Nr. nxënësve			Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm				Nota mesatare
					Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me notë të pamjaftueshme		Të pa notuar		
					Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
		M	F	GJ															
1	Gjuhë shqipe	8434	8072	16506	11827	71.65	2646	16.03	1445	8.75	578	3.50	16496	99.94	9	0.05	1	0.01	4.28
2	Gjuhë angleze	5537	5349	10886	7501	68.91	1547	14.21	1177	10.81	655	6.02	10880	99.94	3	0.03	3	0.03	4.19
3	Histori	1587	1525	3112	2117	68.03	443	14.24	352	11.31	199	6.39	3111	99.97		0.00	1	0.03	4.11
4	Edukatë qytetare	5297	5134	10431	7440	71.33	1491	14.29	983	9.42	509	4.88	10423	99.92	4	0.04	4	0.04	4.25
5	Ed. fizike dhe sportive	8452	8092	16544	15349	92.78	757	4.58	345	2.09	90	0.54	16541	99.98	0	0.00	3	0.02	4.65
6	Matematikë	8456	8095	16551	11483	69.38	2563	15.49	1636	9.88	856	5.17	16538	99.92	11	0.07	2	0.01	4.19
7	Edukatë figurativ	8452	8092	16544	14316	86.53	1335	8.07	705	4.26	183	1.11	16539	99.97	0	0.00	2	0.01	4.56
8	Punëdore	8420	8063	16483	13808	83.77	1507	9.14	896	5.44	268	1.63	16479	99.98	1	0.01	3	0.02	4.5
9	Njeriu dhe natyra	5297	5134	10431	7131	68.36	1605	15.39	1097	10.52	586	5.62	10419	99.88	8	0.08	4	0.04	4.21
10	Edukatë muzikore	8452	8026	16478	14356	87.12	1263	7.66	640	3.88	216	1.31	16475	99.98	0	0.00	3	0.02	4.5

Krahasueshmëria e rezultateve të arritura për secilën lëndë nga klasa I-V gjatë vitit shkollor 2014-15, me rezultatet e arritura gjatë vitit shkollor 2015-16



Graf. 3. Paraqitja e suksesit të nxënësve në nivelit fillor, të arritur për secilën lëndë.

Realizimi i orëve të planifikuara për vitin shkollor 2015/16:


Orët e planifikuara për nivelin e parë të arsimit, për vitin shkollor 2015/16:

-gjithsej **568977 orë,**

-të realizuara **566596 orë,**

-të porealizuara **2381 orë**

Gjithsej të realizuara **99.58**-përqind, ndërsa mesatarja e orëve të realizuara në vitin 2014/15 ishte **99.50**-përqind.



Graf. 4. Paraqitja e realizimit të orëve të planifikuara, të realizuara dhe të pambajtura.


Vijueshmëria e nxënësve:

Gjatë vitit shkollor 2015/16, në nivelin e arsimit fillor janë regjistruar gjithsej **185850 ose 11.00** mungesa për nxënës, prej tyre:

- të arsyeshme **160555 ose 6.83** mungesa për nxënës, të paarsyeshme **25295 ose 1.49** mungesa për nxënës.


Numri i nxënësve për këtë nivel të arsimit gjatë vitit shkollor 2015/16:

-**16892** nxënës, prej tyre **M 8562**, ose **50.68**-përqind dhe **F 8330**, ose **49.31**-përqind.



Graf. 5. Paraqitja e mungesave të nivelit (I-V).

Duhet theksuar se në krahasim me vitin paraprak në këtë vit kemi një rënie të theksuar të mungesave në këtë nivel të arsimit, prej 35.21-përqind.




Graf. 6. Krahasueshmëria e mungesave të vitit shkollor 2014-15, me vitit shkollor 2015-16 - nivelit (I-V).

SUKSESI NË NIVELIN E ARSIMIT TË MESËM I ULËT- (VI-IX)

Numri i përgjithshëm i nxënësve në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, VI – IX është **14105** nxënës, të shpërndarë në **568** paralele, mesatarisht **24.83** nxënës për paralele. Prej tyre **14077** nxënës kanë përfunduar me sukses pozitiv ose **99.80**-përqind, ndërsa **13** nxënës me sukses të pamjaftueshëm ose **0.09**-përqind, dhe **15** nxënës të pa notuar ose **0.10**-përqind, gjegjësisht:

- ⇒ me sukses të shkëlqyeshëm **5791** nxënës ose **41.06**-përqind,
- ⇒ me sukses shumë të mirë **3041** nxënës ose **21.56**-përqind,
- ⇒ me sukses të mirë **3341** nxënës ose **23.69**-përqind,
- ⇒ me sukses të mjaftueshëm **1904** nxënës ose **13.50**-përqind,
- ⇒ me sukses të pamjaftueshëm **13** nxënës ose **0.09**-përqind, dhe
- ⇒ të panotuar **15** nxënës ose **0.10**-përqind.



Graf. 7. Pasqyron suksesin e nxënësve të nivelit të mesëm të ulët (VI-IX).

Ajo që bie në sy është fakti se në këtë nivel të arsimit ka një dallim të dukshëm në vlerësim, në raport me vlerësimin e nivelit fillor. Por, nëse krahasohet me rezultatet e vlerësimit të jashtëm shihet se këtë vit ka një vlerësim apo standard më të përafërt në krahasim me vitin që pasuam.

Nota mesatare në këtë nivel të arsimit është **3.89**, krahasuar me suksesin e vitit paraprak, në këtë nivel të arsimit sukcesi ka shënuar një ngritje të lehtë për **0.03** - përqind.


Sukcesi i nxënësve të arritur për secilën lëndë

Drejtoria e Arsimit edhe për këtë nivel të arsimit në fund të vitit shkollor **2015/16**, ka realizuar një analizë të përgjithshme, suksesit dhe rezultateve të nxënësve të arritur për secilën lëndë, duke krahasuar me rezultatet e vitit paraprak dhe me rezultatet e vlerësimit të jashtëm. Nga kjo analizë konstatohet se nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm këtë vit ka një standard të vlerësimit më të përafërt .

Në vijim paraqesim rezultatet:

Nr	Lënda	Nr. nxënësve			Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm				
					Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me notë të pamjaftueshme		Të pa notuar		Nota mesatare
					Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	
		M	F	GJ															
1	Gjuhë shqipe	7110	6777	13887	5771	41.56	2305	16.60	2761	19.88	2983	21.48	13820	99.52	56	0.40	11	0.08	3.65
2	Gjuhë angleze	7110	6777	13887	6333	45.60	2149	15.47	2352	16.94	3012	21.69	13846	99.70	34	0.24	7	0.05	3.56
3	Gjuhë gjermane	329	299	628	386	61.46	94	14.97	90	14.33	58	9.24	628	100.00					4.25
4	Histori	7110	6777	13887	5889	42.41	2064	14.86	2504	18.03	3343	24.07	13800	99.37	77	0.55	10	0.07	3.61
5	Edukatë qytetare	7110	6777	13887	6631	47.75	2200	15.84	2494	17.96	2533	18.24	13858	99.79	19	0.14	10	0.07	3.85
6	Biologji	7110	6777	13887	5725	41.23	2141	15.42	2744	19.76	3224	23.22	13834	99.62	38	0.27	15	0.11	3.52
7	Fizikë	7110	6777	13887	4856	34.97	2051	14.77	2914	20.98	4011	28.88	13832	99.60	44	0.32	11	0.08	3.45
8	Ed. fizike dhe sportive	7110	6777	13887	9931	71.51	2409	17.35	1162	8.37	370	2.66	13872	99.89	4	0.03	11	0.08	4.41
9	Teknologji	7110	6777	13887	7104	51.16	2271	16.35	2447	17.62	2041	14.70	13863	99.83	13	0.09	11	0.08	3.82
10	Matematikë	7110	6777	13887	4469	32.18	2121	15.27	2658	19.14	4553	32.79	13801	99.38	76	0.55	10	0.07	3.23
11	Gjeografi	7110	6777	13887	5688	40.96	2043	14.71	2583	18.60	3531	25.43	13845	99.70	32	0.23	10	0.07	3.5
12	Art figurativ	7110	6777	13887	8388	60.40	2114	15.22	1887	13.59	1477	10.64	13866	99.85	10	0.07	11	0.08	4.2
13	Kimi	5461	5207	10668	3780	35.43	1720	16.12	2099	19.68	3017	28.28	10616	99.51	46	0.43	6	0.06	3.47
14	Edukatë muzikore	7110	6777	13887	7320	52.71	2142	15.42	2240	16.13	2150	15.48	13852	99.75	24	0.17	11	0.08	3.99

Krahasueshmëria e rezultateve të arritura për secilën lëndë nga klasa VI-IX gjatë vitit shkollor 2014-15, me rezultatet e arritura gjatë vitit shkollor 2015-16



Graf. 8. Paraqitja e suksesit për secilën lëndë, të nxënësve në nivelin e mesëm të ulët (VI-IX).

REZULTATET E TESTIT TË ARRITSHMËRISË 2015-16

Drejtoria e Arsimit, në mënyrë që Testi i arritshmërisë të organizohet dhe të zhvillohet sipas standardeve të niveleve bashkëkohore, ka realizuar një analizë dhe vlerësimi të përgjithshëm mbi rezultatet e viteve paraprake, formës së organizimit dhe ecurisë së këtij procesit dhe ka ndërmarrë gjitha masat e nevojshme për një proces të drejtë:

1. Ka bërë ndryshime në formën dhe organizimin e testit, duke e shtuar numrin e qendrave dhe duke krijuar kushte dhe standarde të mira për punë, gjë që ka reflektuar pozitivisht në mbarëvajtjen e testit dhe rezultate më të mira dhe reale;
2. Për një proces të mirëfilltë të testimit dhe vlerësimit të standardizuar, është viti i dytë që implementohet një formën e re e organizimit të Testit Arritshmërisë, një nxënës një bankë dhe kjo formë ka reflektuar pozitivisht në ecurinë dhe cilësinë e këtij procesi;
3. Janë organizuar takime pune me drejtuesit e institucioneve edukativo-arsimore dhe mësimdhënësit të cilët e kanë administruar dhe monitoruar procesin e Testit të Arritshmërisë;
4. Për një proces të drejtë, Drejtoria e Arsimit ka nxjerrë vendim për detyrat dhe përgjegjësitë e administruesve;
5. Po ashtu, Drejtoria e Arsimit ka realizuar një analizë dhe vlerësim të përgjithshëm suksesit dhe rezultateve të arritura nga nxënësit e të tri niveleve të arsimit parauniversitar, duke krahasuar dhe analizuar rezultatet e vlerësimit të brendshëm me rezultatet e vlerësimit të jashtëm, kur dihet se procesi i vlerësimit është një ndër çështjet më të ndjeshme dhe sfiduese për sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës.


Rezultatet e Testit të Arritshmëria në nivel komune janë **69.12-përqind**. Ne konsiderojmë se këto rezultate janë të kënaqshme në raport me vitin paraprak, ku në këtë vit kemi ngritje të rezultateve 8.42-përqind. Po ashtu, duhet potencuar se në raport me vitin paraprak këtë vit ka një vlerësim më të përafërt të vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm. Por sfiduese për sistemin e arsimit ende mbete një vlerësim real dhe i standardizuar çoftë ky i brendshëm apo i jashtëm. Sa i përket vlerësimit të brendshëm ka dallime të mëdha edhe në mes të vet mësimdhënësve.

Pas analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm të formës dhe organizimit të Testit të Arritshmërisë, konstatojmë se ky proces nuk është duke u realizuar në nivelin dhe standardin e dëshiruar, kur brenda tri orësh nxënësit duhet t'i nënshtrohen testit në nëntë lëndë mësimore, kur merret parasysh se kjo ndikon në masë të madhe edhe në vijimin e shkollimit të nxënësve, presioni është mjaft i madh për moshën e fëmijëve dhe kjo mund të ndikoj negativisht në rezultatet e tyre.

Forma dhe organizimi i Testi të Arritshmërisë, duhet të analizohet mirë dhe të shiqohen edhe praktikatat e shteteve të zhvilluara, në mënyrë që të kemi një organizim dhe proces të përafërt me standardet e vendeve bashkëkohore. Kështu që, testi nuk duhet të realizohet vetëm me një raund, më shumë lëndë dhe më shumë kërkesa (pyetje) brenda tri orëve, por të organizohet në disa raunde si:


1. Gjuhë dhe komunikime
2. Matematikë-informatikë
3. Histori-gjeografi
4. Fizikë, kimi dhe biologji

Kjo formë do ndikoj pozitivisht si në aspektin psikologjik, pedagogji dhe në rezultatet më të mira dhe të besueshme.



Graf. 9. Pasqyron rezultatet e testit të arritshmërisë për secilën lëndë.

Krahasueshmëria në mes vlerësimit të brendshëm me vlerësimin e jashtëm:



Graf. 10. Pasqyron krahasueshmërinë e vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm.

Realizimi i orëve të planifikuara për vitin shkollor 2015/16:


Orët e planifikuara për nivelin e dytë të arsimit, për vitin shkollor 2015/16:

-gjithsej **576017** -orë,

-të realizuara **568264**-orë,

-të porealizuara **7753**-orë

Në përqindje për këtë vit shkollor, kemi **98.65** – përqind realizimin e orëve të planifikuara, që krahasuar me vitin paraprak kemi një ngritje në realizimin e orëve të planifikuara për **0.07** – përqind.




Graf. 11. Paraqitja e realizimit të orëve të planifikuara, të realizuara dhe të pambajtura.

Vijueshmëria e nxënësve:

Në nivelin e arsimit të mesëm të ulët, gjatë vitit shkollor 2015/16, janë regjistruar gjithsej **462235** ose **32.77** mungesa për nxënës, prej tyre të arsyeshme: **358221** ose **25.39** mungesa për nxënës, të paarsyeshme **104014**, **7.37** mungesa për nxënës.


Numri i nxënësve për këtë nivel të arsimit gjatë vitit shkollor 2015/16:

-**14105** nxënës, prej tyre **M-7169**, ose **50.82**-përqind dhe **F-6936**, ose **49.17**-përqind.



Graf. 12. Paraqitja e mungesave të nivelit (VI-IX).

Në vijim paraqesim në mënyrë grafike mungesat e nxënësve të nivelit të dytë të arsimit, duke krahasuar mungesat e vitit shkollor 2014-15, me mungesat e vitit shkollor 2015-16. Nga kjo analizë vërehet se në këtë nivele të arsimit kemi një trend negativ në vijueshmërinë e nxënësve.




Graf. 13. Krahasueshmëria e mungesave të vitit shkollor 2014-15, me mungesat e vitit shkollor 2015-16 - nivelit (VI-IX).

Mungesat e mësimdhënësve të nivelit fillor dhe të mesëm të ulët (I-IX):

Drejtoria e Arsimit, për të konstatuar vijueshmërinë e mësimdhënësve në procesin edukativo-arsimor, këtë vit ka përpunuar dhe analizuar në detaje të dhënat të ofruar nga institucionet edukativo-arsimore.


Duke ditur se vijueshmëria e rregullt e mësimdhënësve në procesin mësimor, është indikator kyç për realizimin e planprogramit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, kështu që në këtë kontekst është realizuar një statistikë dhe analizë lidhur me mungesat e stafit mësimdhënës.

Në nivelin e arsimit fillor dhe të mesëm të ulët, gjatë vitit shkollor 2015/16, janë regjistruar gjithsej **12830**, **7.91** mungesa për mësimdhënës, prej tyre të arsyeshme: **12522** **7.72** mungesa për mësimdhënës, të paarsyeshme **308**, apo **0.19** mungesa për mësimdhënës.



Graf. 14. Paraqitja e mungesave të mësimdhënësve në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët (I-IX).

Në vijim paraqesim në mënyrë grafike mungesat e stafit edukativo-arsimor, të bërë për çdo muaj gjatë vitit shkollor 2015/16.




Graf. 15. Paraqitja e mungesave për çdo muaj të bërë nga mësimdhënësit e nivelit fillor dhe të mesëm të ulët (I-IX).

SUKSESI NË NIVELIN E ARSIMIT TË MESËM TË LARTË-(X-XII)

Në nivelin e arsimit të mesëm të lartë gjithsej **13** shkolla, ku mësimin e kanë vijuar **10175** nxënës, të shpërndarë në **342** paralele, mesatarisht **29.75** nxënës për paralele. Theksojmë se mesatarja e numrit të nxënësve për paralele, **29.75** për këtë nivel të arsimit është pasojë e numrit të vogël të nxënësve në shkollat profesionale në krahasim me gjimnazet, ku kemi të bëjmë me një stërngarkim të paraleleve. Por, duhet theksuar se regjistrimi i nxënësve në tri vitet e fundit ka shënuar kthesë pozitive, ku kemi vijueshmëri të mirë edhe në shkollat profesionale.

Kalueshmëria e nxënësve, në këtë nivel të arsimit është: **98.97** nxënës me sukses pozitiv apo **97.26**-përqind, ndërsa **175** nxënës me sukses të pamjaftueshëm apo **1.72**-përqind, dhe **103** të panotuar, apo **1.01**-përqind, prej tyre:

- ⇒ me sukses të shkëlqyeshëm **2737** nxënës ose **26.90**-përqind
- ⇒ me sukses shumë të mirë **2625** nxënës ose **25.80**-përqind
- ⇒ me sukses të mirë **2845** nxënës ose **27.96**-përqind
- ⇒ me sukses të mjaftueshëm **1690** nxënës ose **16.61**-përqind
- ⇒ me sukses të pamjaftueshëm **175**, nxënës ose **1.72**-përqind
- ⇒ të panotuar **103** nxënës ose **1.01**-përqind:



Graf. 16. Pasqyron suksesin e nxënësve të nivelit të mesëm të lartë (X-XII).

Nota mesatare e nxënësve të këtij niveli të arsimit është **3.58**, që krahasuar me notën mesatare e vitit të kaluar ka shënuar një ngritje të lehtë për **0.04-përqind**.


Në bazë të analizës dhe vlerësimit të përgjithshëm suksesit në këtë nivel të arsimit, konsiderohet një rezultat i kënaqshëm, por kërkohet edhe një angazhim më i madh nga drejtuesit dhe mësimdhënësit e shkollës në mënyrë që të shënohet progres edhe më i theksuar në ngritjen e rezultateve.

Suksesi i arritur në lëndët e përgjithshme

Gjithashtu, edhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë kemi analizuar suksesin e arritur të nxënësve, për lëndët e përgjithshme.

Nr	Lënda	Nr. nxënësve			Suksesi pozitiv										Suksesi i pamjaftueshëm					
					Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Gjithsej me nota pozitive		Me notë të pamjaftueshme		Të pa notuar		Nota mesatare	
					Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%		
		M	F	GJ																
1	Gjuhë shqipe	4846	5254	10100	3318	32.85	1472	14.57	2016	19.96	3089	30.58	9895	97.97	116	1.15	89	0.88	3.44	
2	Gjuhë angleze	4846	5254	10100	3572	35.37	1687	16.70	1846	18.28	2834	28.06	9939	98.41	72	0.71	89	0.88	3.55	
3	Gjuhë gjermane	1564	2113	3677	1381	37.56	639	17.38	731	19.88	907	24.67	3658	99.48	2	0.05	17	0.46	3.19	
4	Gjuhë frenge	711	835	1546	717	46.38	307	19.86	237	15.33	258	16.69	1519	98.25	0	0.00	27	1.75	3.68	
5	Gjuhë latine	258	391	649	369	56.86	84	12.94	73	11.25	122	18.80	648	99.85	0	0.00	1	0.15	3.82	
6	Histori	2625	3106	5731	2637	46.01	846	14.76	990	17.27	1174	20.49	5647	98.53	21	0.37	63	1.10	3.51	
7	Edukatë qytetare	1984	1881	3865	1367	35.37	514	13.30	645	16.69	1248	32.29	3774	97.65	37	0.96	54	1.40	3.59	
8	Biologji	2573	3388	5961	1822	30.57	1006	16.88	1218	20.43	1837	30.82	5883	98.69	12	0.20	66	1.11	3.33	
9	Fizikë	3470	3770	7240	1755	24.24	997	13.77	1480	20.44	2869	39.63	7101	98.08	82	1.13	57	0.79	2.68	
10	Edukatë fizike dhe sportive	4846	4977	9823	6958	70.83	1552	15.80	849	8.64	373	3.80	9732	99.07	2	0.02	89	0.91	4.45	
11	Teknologji	4816	5227	10043	3134	31.21	1532	15.25	2217	22.08	3012	29.99	9895	98.53	60	0.60	88	0.88	3.41	
12	Matematikë	4601	4870	9471	1586	16.75	1081	11.41	1831	19.33	4746	50.11	9244	97.60	141	1.49	86	0.91	2.82	
13	Gjeografi	2918	3387	6305	2331	36.97	1048	16.62	1108	17.57	1726	27.38	6213	98.54	18	0.29	74	1.17	3.41	
14	Art figurativ	1728	2508	4236	2407	56.82	698	16.48	639	15.08	483	11.40	4227	99.79	2	0.05	7	0.17	3.82	
15	Kimi	3053	3758	6811	1725	25.33	845	12.41	1354	19.88	2776	40.76	6700	98.37	53	0.78	58	0.85	3.2	
16	Sociologji	853	1155	2008	869	43.28	302	15.04	345	17.18	488	24.30	2004	99.80	1	0.05	3	0.15	3.57	
17	Filozofi	450	607	1057	390	36.90	162	15.33	263	24.88	239	22.61	1054	99.72	1	0.09	2	0.19	3.62	
18	Logjikë	281	442	723	297	41.08	98	13.55	154	21.30	173	23.93	722	99.86	0	0.00	1	0.14	3.54	
19	Astronomi	467	559	1026	560	54.58	112	10.92	144	14.04	209	20.37	1025	99.90	0	0.00	1	0.10	4.1	
20	Psikologji	1230	1444	2674	881	32.95	387	14.47	560	20.94	787	29.43	2615	97.79	15	0.56	44	1.65	3.57	
21	Ekonomi	2261	1713	3974	877	22.07	418	10.52	658	16.56	1863	46.88	3816	96.02	85	2.14	73	1.84	3.27	
22	Edukatë muzikore	1663	2460	4123	2495	60.51	746	18.09	437	10.60	439	10.65	4117	99.85	2	0.05	4	0.10	4.22	

Krahasueshmëria e rezultateve të arritura për cilën lëndë nga klasa X-XII gjatë vitit shkollor 2014-15, me rezultatet e arritura gjatë vitit shkollor 2015-16



Graf. 17. Paraqitja e suksesit për lëndët e përgjithshme, të nxënësve në nivelin e mesëm të lartë (X-XII).

REZULTATET E PROVIMIT SHTETËROR TË MATURËS

Në vitin shkollor 2015/16, nga puna jonë në shkolla mund të konstatojmë se organizimi, menaxhimi dhe mbarëvajtja e provimit shtetëror të maturës ishte në nivel më të kënaqshëm, në krahasim me vitet paraprake. Por, konsiderojmë se akoma sfiduese mbeten: përgatitja e testeve sipas profileve dhe planprogrameve që zhvillojnë shkollat e ndryshme, modeli me shumë lëndë mësimore, pyetje të parashtruar për nxënës nga lëndë të cilat nuk kanë qenë pjesë planprogramit të shkollimit të arsimit të mesëm të lartë, shumë kërkesa për testin njëditor, tendenca e vazhdueshme e nxënësve për kopjim dhe në disa raste edhe administruesit-monitoruesit nuk janë në nivelin e përgjegjësive të punëve dhe detyrave të përcaktuara.


Do të theksonim se pjesa e parë e testit të maturës përpilohet i njëjtë si për gjimnaze ashtu edhe për shkolla profesionale, gjë që sipas nesh nuk është në rregull kur dihet se gjimnazet p.sh. në lëndën e matematikës kanë katër (4) e më shumë orë mësim në javë, ndërsa shkollat profesionale dy (2) orë në javë.

Në afatin e parë me datë 4 dhe 18 qershor, në Komunën e Prishtinës provimit shtetëror të maturës iu nënshtruan **3846** maturantë, ku sukses pozitiv kanë arritur **3037** nxënës, apo **78.97** – përqind.

Ndërsa, në afatin e dytë, më **27** gusht dhe me **3** shtator, provimit iu kanë nënshtruar **1137** maturantë, prej tyre sukses pozitiv kanë arritur **735** nxënës, apo **64.64**-përqind.

Në këtë vit shkollor, provimin e maturës shtetërore në Komunën e Prishtinës e kanë kaluar **3772** nxënës apo **90.36** –përqind. Krahasuar me suksesin e vitit paraprak, është shënuar një ngritje e theksuar e kalueshmërisë prej **7.48**-përqind.

Kjo ngritje e kalueshmërisë prej 7.48-përqind është si rezultat i punëve dhe detyrave të realizuar në përmirësimin e cilësisë në institucionet edukativo-arsimore, dhe po ashtu ka reflektuar edhe ulja e kriterit të kalueshmërisë së provimit shtetëror të maturës nga 50% në 40%, sipas Ligjit të ri të maturës.



Graf. 18. Paraqitja e rezultateve të Testit të Maturës.


Për të përmirësuar cilësinë e të nxënësve të nxënësve, metodologjinë e mësimdhënies dhe përgjithësisht punën në shkollë, praktikohet realizimi i vlerësimit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm.

Edhe në këtë vit është realizuar një analizë e përgjithshme e rezultatit të provimit të maturës për secilën lëndë, duke e krahasuar me rezultatet e brendshme të vlerësimit. Duke e ditur se vlerësimi i brendshëm ende nuk është monitoruar në nivel kombëtar dhe nuk ka një analizë reale për dallimet në mes ndryshimit në vlerësimin e brendshëm dhe atij të jashtëm. Kjo situatë vë në pah në mënyrë shumë të dukshme edhe në dallimet nga një shkollë në tjetrën, për shkak të moszbatimit të kriterëve të standardizuara në vlerësimin e brendshëm. Pra, është evident fakti se ka mungesë të harmonizimit të vlerësimit të brendshëm brenda vetë shkollave, e kur bëhet fjala për vlerësimin e jashtëm ka një disproporcion edhe më të madh.

Vlerësimi brendshëm dhe i jashtëm mbetet ende sfidë për sistemin e arsimit, këtë e dëshmojnë statistikatat dhe grafikonet e paraqitura, se nuk është arritur akoma një standard i dëshirueshëm të cilësia e vlerësimit.

LËNDËT E PËRGJITHSHME


Dita e parë: 100 kërkesa (pyetje)



Graf. 19. Paraqitja e rezultatit të arritur në lëndët e përgjithshme.

GJIMNAZI GJUHËSOR

Dita e dytë: 100 kërkesa (pyetje)



Graf. 20. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin gjuhësor, dita e dytë.

GJIMNAZI I PËRGJITHSHËM


Dita e dytë: 100 kërkesa (pyetje)



Graf. 21. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin e përgjithshëm, dita e dytë.

GJIMNAZI MATEMATIKOR


Dita e dytë: 100 kërkesa (pyetje)



Graf. 22. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin e matematikor, dita e dytë.

GJIMNAZI NATYROR


Dita e dytë: 100 kërkesa (pyetje)



Graf. 23. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin natyror, dita e dytë.


GJIMNAZI SHOQËROR

Dita e dytë: 100 kërkesa (pyetje)



Graf. 24. Paraqitja e rezultatit të arritur në gjimnazin shoqëror, dita e dytë.


ARSIMI PROFESIONAL-1(Shëndetësi, Bujqësi, Hortikulturë, Teknologji ushqimore, kimi-
teknologji, Gjeologji) **Dita e dytë 100 kërkesa**



Graf. 25. Paraqitja e rezultatit të arritur në arsimin profesional-I.


ARSIMI PROFESIONAL-II (TIK, Komunikacion, Ndërtimtari, Arkitekturë, Gjeodezi, Tekstil,
Xehetari)

Dita e dytë: 100 kërkesa




Graf. 26. Paraqitja e rezultatit të arritur në arsimin profesional-II.

ARSIMI PROFESIONAL-III (Administratë, Ekonomi, Hoteleri, Turizëm, Shërbimi
postë-Telefoni) **Dita e dytë: 100 kërkesa**




Graf. 27. Paraqitja e rezultatit të arritur në arsimin profesional-III.

ARSIMI PROFESIONAL-IV (Muzikë) Dita e dytë



Graf. 28. Paraqitja e rezultatit të arritur në arsimin profesional-IV.

ARSIMI PROFESIONAL-V (Art dhe Grafikë) Dita e dytë




Graf. 29. Paraqitja e rezultatit të arritur në arsimin profesional-V.

Orët e planifikuara për nivelin e tretë të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2015/16:

- gjithsej **359491** orë,
- të realizuara **349458** orë,
- të porealizuara **10033** orë

Orët e planifikuara për këtë vit shkollor janë realizuar **97.20** – përqind, që krahasuar me vitin paraprak, ka progres në realizim për **0.42** – përqind.




Graf. 30. Paraqitja e realizimit të orëve të planifikuara, të realizuara dhe të pambajtura (X-XII).

Vijueshmëria e nxënësve:

Gjatë vitit shkollor 2015/16, në nivelin e mesëm të lartë janë regjistruar gjithsej **547303**, **53.78** mungesa për nxënës, prej tyre të arsyeshme:- **307484**, **30.21** mungesa për nxënës, të paarsyeshme:- **239500**, **23.53** mungesa për nxënës.


Numri i nxënësve për këtë nivel të arsimit gjatë vitit shkollor 2015/16:

-**10175** nxënës, prej tyre **M-4881**, ose **47.97**-përqind dhe **F-5294** ose **52.02**-përqind.



Graf. 31. Paraqitja e mungesave të nivelit (X-XII).

Nga të dhënat e prezantuar dhe krahasimi i mungesave të vitit shkollor 2014-15, me mungesat e vitit shkollor 2015-16, konstatojmë se në këtë nivel të arsimit ka një trend pozitiv në rënie të mungesave nga ana e nxënësve.




Graf. 32. Krahasueshmëria e mungesave të vitit shkollor 2014-15, me mungesat e vitit shkollor 2015-16 - nivelit (X-XII).

Mungesat e mësimdhënësve (X-XII):


Po ashtu edhe në nivelin e arsimit të mesëm të lartë, janë përpunuar dhe analizuar të dhënat, lidhur me mungesat e mësimdhënësve në institucionet edukativo-arsimore.

Pra në këtë nivel të arsimit, gjatë vitit shkollor **2015/16**, janë regjistruar gjithsej **7402, 12.19** mungesa për mësimdhënës, prej tyre të arsyeshme: **6307 ose 10.39** mungesa për mësimdhënës, të paarsyeshme **1095, apo 1.80** mungesa për mësimdhënës.



Graf. 33. Paraqitja e mungesave të mësimdhënësve në nivelin e mesëm të lartë (X-XII).

Në vijim paraqesim në mënyrë grafike mungesat e stafit edukativo-arsimor, të bërë për çdo muaj gjatë vitit shkollor 2015/16.



Graf. 34. Paraqitja e mungesave për çdo muaj të bërë nga mësimdhënësit e nivelit të mesëm të lartë (X-XII).

Tabelat e përgjithshme të suksesit:

Në vijim do t'i prezantojmë tabelat e suksesit të fundvitit shkollor 2015-16, për rezultatet e nxënësve të arritura në të tri nivelet e arsimit parauniversitar dhe krahasueshmëria në mes vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm:

Niveli i arsimit fillor (I - V)


	Shkolla	Nr. paraleleve	Kaluan klasën me sukses											Përcillen		Gjithsej orë gjatë vitit				
			Numri i nxënësve			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative		Të pa notuar		Të planifikuara	Të mbajtura	Nota mesatare
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%			
1	"Asim Vokshi"	14	168	156	324	233	71.91	53	16.36	32	9.88	6	1.85		0.00		0.00	11626	11607	4.53
2	"Dardania"	31	497	484	981	850	86.65	89	9.07	36	3.67	6	0.61		0.00		0.00	25663	25663	4.81
3	"Elena Gjika"	31	477	434	911	818	89.79	69	7.57	23	2.52	1	0.11	0	0.00	0	0.00	25937	25720	4.83
4	"Emin Duraku"	16	181	150	331	284	85.80	25	7.55	17	5.14	5	1.51	0	0.00		0.00	4173	4169	4.75
5	"Faik Konica"	26	359	396	755	666	88.21	67	8.87	21	2.78	1	0.13		0.00		0.00	21486	21276	4.80
6	"Gjergj Fishta"	23	290	266	556	437	78.60	88	15.83	24	4.32	6	1.08	1	0.18		0.00	18981	18981	4.65
7	"Hasan Prishtina"	35	560	532	1092	1029	94.23	54	4.95	9	0.82	0	0.00	0	0.00	0	0.00	29267	29267	4.92
8	"Ismail Qemali"	45	777	759	1536	1377	89.65	135	8.79	20	1.30	4	0.26	0	0.00	0	0.00	36381	36315	4.85
9	"Iliria"	30	362	389	751	595	79.23	102	13.58	42	5.59	10	1.33	2	0.27		0.00	24795	24785	4.69
10	"Meto Bajraktari"	27	483	412	895	668	74.64	130	14.53	84	9.39	13	1.45		0.00		0.00	16487	16487	4.58
11	"Nazim Gafurri"	22	255	252	507	346	68.24	92	18.15	52	10.26	15	2.96	1	0.20	1	0.20	18384	18384	4.50
12	"Naim Frashëri"	26	234	224	458	384	83.84	52	11.35	22	4.80	0	0.00	0	0.00	0	0.00	21620	21620	4.74
13	"Pjetër Bogdani"	18	162	193	355	272	76.62	58	16.34	20	5.63	5	1.41	0	0.00	0	0.00	14831	14792	4.52
14	"Zenel Hajdini"	32	367	366	733	600	81.86	89	12.14	40	5.46	4	0.55		0.00		0.00	26171	26155	4.72
15	"7 Marsi"	10	152	154	306	217	70.92	60	19.61	29	9.48		0.00		0.00		0.00	8264	8066	4.6
16	"Xhemail Mustafa"	20	348	320	668	612	91.62	44	6.59	10	1.50	2	0.30		0.00		0.00	4137	4133	4.85
17	"Hilmi Rakovica"	24	363	369	732	515	70.36	147	20.08	57	7.79	13	1.78		0.00		0.00	19869	19656	4.55
18	"Azemi e Salihu"	12	14	13	27	13	48.15	7	25.93	7	25.93		0.00		0.00		0.00	9993	9902	4.02
19	"Avni Rrustemi"	15	46	36	82	48	58.54	18	21.95	10	12.20	6	7.32		0.00	0	0.00	12414	12392	4.23
20	"Andon Z.Çajupi"	15	257	250	507	364	71.79	63	12.43	50	9.86	30	5.92		0.00		0.00	12491	12477	4.5
21	"Ali Kelmendi"	7	75	71	146	73	50.00	31	21.23	32	21.92	10	6.85		0.00		0.00	5955	5825	3.96
22	"Dituria"	6	77	64	141	90	63.83	25	17.73	22	15.60	4	2.84	0	0.00	0	0.00	4850	4849	4.36

23	"Ditët e Minoritit"	14	56	48	104	71	68.27	19	18.27	11	10.58	3	2.88	0	0.00	0	0.00	11618	11403	4.57
24	"Dëshmorët e 1921"	9	8	3	11	8	72.73	1	9.09	2	18.18	0	0.00	0	0.00	0	0.00	4062	4062	4.58
25	"Fan S.Noli"	4	7	8	15	11	73.33	1	6.67	1	6.67	2	13.33	0	0.00	0	0.00	3441	3428	4.36
26	"Filip Shiroka"	10	26	33	59	36	61.02	12	20.34	7	11.86	4	6.78		0.00		0.00	8362	8322	4.32
27	"Ganimete Terbeshi"	9	64	58	122	83	68.03	18	14.75	11	9.02	10	8.20		0.00		0.00	7398	7344	4.4
28	"Isa Boletini"	5	33	31	64	44	68.75	11	17.19	7	10.94	2	3.13		0.00		0.00	4158	4158	4.33
29	"Liria"	2	0	3	3	3	100.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	1813	1806	5
30	"Mitrush Kuteli"	11	142	104	246	172	69.92	44	17.89	21	8.54	9	3.66		0.00	0	0.00	9129	9122	4.5
31	"Nëna Tereza"	15	86	86	172	129	75.00	29	16.86	13	7.56	1	0.58		0.00		0.00	12487	12487	4.54
32	"Nexhmi Mustafa"	23	176	178	354	199	56.21	88	24.86	51	14.41	16	4.52		0.00		0.00	19277	19277	4.31
33	"Ramiz Sadiku"	2	2	1	3	2	66.67	1	33.33	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	1591	1584	4.5
34	"Rilindja"	8	15	12	27	12	44.44	7	25.93	4	14.81	3	11.11	1	3.70		0.00	6593	6593	4.1
35	"Shkendija"	15	202	187	389	257	66.07	64	16.45	48	12.34	19	4.88	1	0.26		0.00	12490	12480	4.4
36	"Teuta"	5	10	11	21	13	61.90	4	19.05	4	19.05		0.00		0.00		0.00	3976	3976	4.73
37	"Tefik Çanga"	14	24	25	49	29	59.18	14	28.57	6	12.24		0.00		0.00		0.00	11692	11632	4.3
38	"Prenk Jakova"	27	109	240	349	215	61.60	91	26.07	17	4.87	8	2.29	1	0.29	17	4.87	19368	18917	4.31
39	"Xhavit Ahmeti"	21	235	228	463	339	73.22	90	19.44	28	6.05	6	1.30		0.00		0.00	17536	17463	4.65
40	"Pavarësia"	20	322	303	625	510	81.60	69	11.04	44	7.04	2	0.32		0.00		0.00	16724	16560	4.7
41	"Shkolla e Gjelbër"	10	184	176	360	244	67.78	78	21.67	35	9.72	3	0.83		0.00		0.00	6422	6422	4.53
42	"Afrim Gashi"	11	160	140	300	181	60.33	67	22.33	35	11.67	15	5.00	2	0.67		0.00	8731	8717	4.34
43	Shkolla Model	10	197	165	362	235	64.92	74	20.44	53	14.64		0.00		0.00		0.00	8334	8322	4.49
Gjithsej		730	8562	8330	16892	13284	78.64	2280	13.50	1057	6.26	244	1.44	9	0.05	18	0.11	568977	566596	4.53


**Paraqitja grafike e notës mesatare për secilën shkollë - klasa I-V
për vitin shkollor 2015-16**

Nr.	Shkolla	N.M 2014-15	N.M 2015-16
1	"Asim Vokshi"	4.53	4.53
2	"Dardania"	4.81	4.818
3	"Elena Gjika"	4.78	4.83
4	"Emin Duraku"	4.73	4.75
5	"Faik Konica"	4.79	4.80
6	"Gjergj Fishta"	4.65	4.65
7	"Hasan Prishtina"	4.88	4.92
8	"Ismail Qemali"	4.86	4.85
9	"Iliria"	4.59	4.69
10	"Meto Bajraktari"	4.59	4.58
11	"Nazim Gafurri"	4.51	4.50
12	"Naim Frashëri"	4.74	4.74
13	"Pjetër Bogdani"	4.58	4.52
14	"Zenel Hajdini"	4.66	4.72
15	"7 Marsi"	4.56	4.6
16	"Xhemail Mustafa"	4.83	4.85
17	"Hilmi Rakovica"	4.48	4.55
18	"Azemi e Salihu"	4.08	4.02
19	"Avni Rrustemi"	4.06	4.23
20	"Andon Z.Çajupi"	4.36	4.5
21	"Ali Kelmendi"	3.86	3.96

Krahasueshmëria e suksesit 2014/15, me suksesin e vitit 2015/16



**Paraqitja grafike e notës mesatare për secilën shkollë - klasa I-V
për vitin shkollor 2015-16**



Suksesi i nxënësve në fund të vitit shkollor 2015/16


Niveli i arsimit të mesëm të ulët (VI-IX)

Klasa	Shkolla	Nr. paraleleve	Kalan klasën me sukses												Kanë përsëritur klasën				Gjithsej orë gjatë vitit				
			Nr.xneshve			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative		Të pa notuar		Të planifikuara	Të mbajtura	Nota mesatare	Vlerësimi i brendshëm	Vlerësimi i jashtëm	
			M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%						
1	"Asim Vokshi"	14	175	171	346	168	48.55	58	16.76	68	19.65	52	15.03		0.00		0.00	14901	14692	3.95	79	59.92	
2	"Dardania"	24	377	383	760	321	42.24	163	21.45	193	25.39	83	10.92		0.00		0.00	25230	24817	3.95	79	75.83	
3	"Elena Gjika"	24	344	339	683	348	50.95	153	22.40	125	18.30	57	8.35	0	0.00	0	0.00	25614	25450	4.21	84.2	78.27	
4	"Emin Duraku"	16	189	171	360	122	33.89	75	20.83	107	29.72	53	14.72	0	0.00	3	0.83	4268	4118	3.74	74.8	61.84	

5	"Faik Konica"	20	273	248	521	253	48.56	130	24.95	115	22.07	23	4.41		0.00		0.00	20770	20345	4.105	82.1	76.23
6	"Gjergj Fishta"	22	263	262	525	250	47.62	89	16.95	112	21.33	74	14.10		0.00		0.00	22108	21926	3.87	77.4	72.29
7	"Hasan Prishtina"	27	429	454	883	531	60.14	157	17.78	158	17.89	37	4.19	0	0.00	0	0.00	28663	28594	4.29	85.8	69.80
8	"Ismail Qemali"	33	513	530	1043	528	50.62	244	23.39	187	17.93	82	7.86	0	0.00	2	0.19	35271	34051	4.1	82	75.52
9	"Iliria"	24	316	323	639	215	33.65	128	20.03	150	23.47	146	22.85		0.00		0.00	25173	25125	3.65	73	70.46
10	"Meto Bajraktari"	22	355	365	720	285	39.58	117	16.25	134	18.61	184	25.56		0.00		0.00	32201	32201	3.88	77.6	72.39
11	"Nazim Gafurri"	20	231	259	490	180	36.73	98	20.00	142	28.98	70	14.29		0.00	0	0.00	21275	21190	3.77	75.4	60.44
12	"Naim Frashëri"	22	196	190	386	184	47.67	99	25.65	96	24.87	7	1.81	0	0.00	0	0.00	23524	23424	4.202	84.04	78.76
13	"Pjetër Bogdani"	15	198	192	390	106	27.18	95	24.36	110	28.21	77	19.74	2	0.51	0	0.00	15736	15552	3.59	71.8	65.35
14	"Zenel Hajdini"	27	345	324	669	293	43.80	139	20.78	153	22.87	84	12.56		0.00		0.00	28478	27773	3.94	78.8	61.76
15	"7 Marsi"	9	131	112	243	75	30.86	58	23.87	69	28.40	41	16.87		0.00		0.00	8484	8442	3.69	73.8	53.51
16	"Xhemal Mustafa"	16	290	244	534	259	48.50	130	24.34	100	18.73	45	8.43		0.00		0.00	4120	4073	4.03	80.6	72.42
17	"Hilmi Rakovica"	21	364	322	686	161	23.47	165	24.05	238	34.69	120	17.49		0.00	2	0.29	20425	20266	3.48	69.6	63.12
18	"Azemi e Salihu"	11	12	8	20	4	20.00	6	30.00	8	40.00	2	10.00		0.00		0.00	11572	11501	4.61	92.2	41.80
19	"Avni Rustemi"	4	51	55	106	31	29.25	22	20.75	33	31.13	20	18.87	0	0.00	0	0.00	4227	4172	3.55	71	70.03
20	"Andon Z.Çajupi"	12	271	224	495	142	28.69	96	19.39	119	24.04	138	27.88		0.00		0.00	12807	12346	3.46	69.2	66.09
21	"Ali Kelmendi"	8	85	99	184	60	32.61	35	19.02	46	25.00	43	23.37		0.00		0.00	8658	8208	3.5	70	68.38
22	"Dituria"	5	49	75	124	59	47.58	27	21.77	24	19.35	14	11.29	0	0.00	0	0.00	5077	4995	4.08	81.6	52.03
23	"Ditët e Minoritit"	8	59	45	104	33	31.73	28	26.92	27	25.96	14	13.46	0	0.00	2	1.92	8538	8356	3.81	76.2	63.46
24	"Dëshmorët e 1921"	5	7	6	13	6	46.15	3	23.08	4	30.77	0	0.00	0	0.00	0	0.00	5279	5279	4.25	85	36.75
25	"Fan S.Noli"	2	4	0	4	0	0.00	2	50.00	2	50.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	2123	2102	3.7	74	64.50
26	"Filip Shiroka"	4	20	23	43	18	41.86	6	13.95	15	34.88	4	9.30		0.00		0.00	4356	4309	3.8	76	77.80
27	"Ganimete Terbeshi"	8	73	50	123	56	45.53	34	27.64	18	14.63	15	12.20		0.00		0.00	8405	8290	4.06	81.2	63.68
28	"Isa Boletini"	4	33	24	57	19	33.33	11	19.30	15	26.32	12	21.05		0.00		0.00	4251	4155	3.57	71.4	76.38
29	"Liria"	4	7	0	7	5	71.43	2	28.57	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	4306	4281	4.1	82	69.50
30	"Mitrush Kuteli"	10	122	109	231	96	41.56	54	23.38	45	19.48	33	14.29	0	0.00	3	1.30	10503	10445	3.92	78.4	83.33
31	"Nëna Tereza"	11	60	65	125	72	57.60	28	22.40	24	19.20	1	0.80		0.00		0.00	10827	10827	4.31	86.2	71.04
32	"Nexhmi Mustafa"	16	155	163	318	142	44.65	69	21.70	76	23.90	31	9.75		0.00		0.00	17076	16452	3.91	78.2	63.21
33	"Ramiz Sadiku"	1	0	1	1	0	0.00	1	100.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	0	0.00	1110	1110	4.07	81.4	
34	"Rilindja"	8	22	11	33	12	36.36	9	27.27	12	36.36		0.00		0.00		0.00	8370	8300	4	80	68.38
35	"Shkendija"	12	197	190	387	93	24.03	78	20.16	91	23.51	125	32.30		0.00		0.00	12733	12657	3.36	67.2	66.58
36	"Teuta"	3	13	14	27	17	62.96	4	14.81	6	22.22		0.00		0.00		0.00	3183	3137	4.09	81.8	74.10
37	"Tefik Çanga"	8	24	24	48	11	22.92	20	41.67	16	33.33	1	2.08		0.00		0.00	8652	8600	3.8	76	44.83
38	"Prenk Jakova"	7	21	70	91	43	47.25	28	30.77	9	9.89	8	8.79		0.00	3	3.30	5050	4870	4.01	80.2	
39	"Xhavit Ahmeti"	19	227	218	445	106	23.82	68	15.28	156	35.06	105	23.60	10	2.25	0	0.00	20197	19888	3.35	67	59.52
40	"Pavarësia"	16	273	259	532	200	37.59	145	27.26	145	27.26	41	7.71	1	0.19		0.00	17076	16916	3.97	79.4	67.91
41	"Shkolla e Gjelbër"	8	126	79	205	79	38.54	54	26.34	57	27.80	15	7.32		0.00		0.00	8422	8422	3.81	76.2	76.81
42	"Afrim Gashi"	8	133	108	241	83	34.44	64	26.56	74	30.71	20	8.30		0.00		0.00	8451	8387	3.74	74.8	76.34
43	"Shkolla Model"	10	136	127	263	125	47.53	49	18.63	62	23.57	27	10.27		0.00		0.00	8527	8220	3.99	79.8	74.34
	Gjithsej	568	7169	6936	14105	5791	41.06	3041	21.56	3341	23.69	1904	13.50	13	0.09	15	0.11	576017	568264	3.89	77.8	69.20


Paraqitja grafike e notës mesatare për secilën shkollë - klasa VI-IX
për vitin shkollor 2015/16

Klasa	Shkolla	N.M 2014-15	N.M 2015-16
1	"Asim Vokshi"	4.1	3.95
2	"Dardania"	4.00	3.95
3	"Elena Gjika"	4.2	4.21
4	"Emin Duraku"	3.80	3.74
5	"Faik Konica"	4.20	4.11
6	"Gjergj Fishta"	4	3.87
7	"Hasan Prishtina"	4.2	4.29
8	"Ismail Qemali"	4.2	4.103
9	"Iliria"	3.70	3.65
10	"Meto Bajraktari"	4	3.88
11	"Nazim Gafurri"	3.60	3.77
12	"Naim Frashëri"	4.2	4.202
13	"Pjetër Bogdani"	3.7	3.59
14	"Zenel Hajdini"	3.9	3.94
15	"7 Marsi"	3.9	3.69
16	"Xhemal Mustafa"	4	4.03
17	"Hilmi Rakovica"	3.5	3.48
18	"Azemi e Salihu"	3.9	4.61
19	"Avni Rrustemi"	3.7	3.555
20	"Andon Z.Çajupi"	3.6	3.46
21	"Ali Kelmendi"	3.50	3.50





Paraqitja grafike e notës mesatare për secilën shkollë - klasa VI-IX
për vitin shkollor 2015/16

Klasa	Shkolla	N.M 2014-15	N.M 2015-16
22	"Dituria"	4	4.08
23	"Ditë e Minoritit"	3.8	3.81
24	"Dëshmorët e 1921"	3.8	4.25
25	"Fan S.Noli"	3.2	3.7
26	"Filip Shiroka"	3.9	3.8
27	"Ganimete Terbeshi"	3.7	4.06
28	"Isa Boletini"	3.7	3.57
29	"Liria"	5	4.1
30	"Mitrush Kuteli"	3.7	3.92
31	"Nëna Tereza"	4.4	4.31
32	"Nexhmi Mustafa"	3.8	3.91
33	"Ramiz Sadiku"	4.5	4.07
34	"Rilindja"	4	4
35	"Shkendija"	3.3	3.36
36	"Teuta"	4.2	4.09
37	"Tefik Çanga"	3.6	3.8
38	"Prenk Jakova"	3.9	4.01
39	"Xhavit Ahmeti"	3.1	3.35
40	"Pavarësia"	4	3.97
41	"Shkolla e Gjelbër"	3.7	3.81
42	"Afrim Gashi"	3.7	3.74
43	"Shkolla Model"	3.8	3.99



Krahasueshmëria e vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm




Suksesi i nxënësve në fundvitin shkollor 2015/16

Arsimi i mesëm i lartë (X-XII)


Emri i shkollës	Nr. paraleleve	Nr. nxënësve			Shkëlqyeshëm		Sh. mirë		Mirë		Mjaftueshëm		Me nota negative		Të pa notuar		Gjithsej orë gjatë vitit			Vlerësimi i brendshëm	Vlerësimi i jashtëm
		M	F	GJ	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Nr	%	Të planifikuara	Të mbajtura	Nota mesatare		
		Kanë përsëritur klasën																			
1 "Sami Frashëri"	35	534	663	1197	548	45.78	455	38.01	183	15.29	10	0.84	1	0.08	0	0.00	36240	33696	4.197	83.93	77.65
2 "Ahmet Gashi"	40	534	830	1364	332	24.34	512	37.54	407	29.84	113	8.28	0	0.00	0	0.00	36873	35951	3.73	74.6	63.62
3 "Xhevdet Doda"	35	541	743	1284	578	45.02	418	32.55	240	18.69	46	3.58	0	0.00	2	0.16	35670	35449	4.187	83.75	67.74
4 "Eqrem Çabej"	24	301	558	859	147	17.11	174	20.26	298	34.69	235	27.36	1	0.12	4	0.47	13302	13056	3.39	67.8	55.87
5 "Dr.Ali Sokoli"	23	207	521	728	366	50.27	176	24.18	148	20.33	34	4.67	0	0.00	4	0.55	24171	23884	4.22	84.4	60.92
6 "28 Nëntori"	43	618	373	991	113	11.40	167	16.85	350	35.32	337	34.01	24	2.42	0	0.00	46338	45456	2.99	59.8	40.64
7 "H. K.Prishtina"	41	656	640	1296	201	15.51	221	17.05	435	33.56	394	30.40	44	3.40	1	0.08	43727	43149	3.31	66.2	54.83
8 "7 Shtatori"	10	118	99	217	26	11.98	33	15.21	54	24.88	88	40.55	4	1.84	12	5.53	10912	10659	3.07	61.4	38.04
9 "Abdyli Frashëri"	22	303	186	489	74	15.13	64	13.09	155	31.70	123	25.15	14	2.86	59	12.07	23335	22976	3.17	63.41	35.44
10 "Prenk Jakova"	6	44	56	100	21	21.00	28	28.00	33	33.00	11	11.00	6	6.00	1	1.00	19021	18438	3.53	70.6	67.79
11 "Gjin Gazulli"	35	555	267	822	82	9.98	148	18.00	309	37.59	226	27.49	57	6.93	0	0.00	38336	36619	3	60	46.83
12 "Alauddin"	25	435	323	758	219	28.89	207	27.31	217	28.63	72	9.50	24	3.17	19	2.51	28208	26899	3.71	74.21	59.95
13 "Gjimnazi Matematikor"	3	35	35	70	30	42.86	22	31.43	16	22.86	1	1.43	0	0.00	1	1.43	3358	3226	4.10	82	0.00
Gjithsej	342	4881	5294	10175	2737	26.90	2625	25.80	2845	27.96	1690	16.61	175	1.72	103	1.01	359491	349458	3.58	71.6	55.77

Paraqitja grafike e notës mesatare për secilën shkollë klasa X-XII
për vitin shkollor 2015/16

Nr.	Emri i shkollës	N. M 2014-15	N. M 2015- 16
1	"Sami Frashëri"	4.23	4.19
2	"Xhevdet Doda"	3.9	4.18
3	"Eqrem Çabej"	3.89	3.39
4	"Dr.Ali Sokoli"	3.17	4.22
5	"28 Nëntori"	4.1	2.99
6	"H. K.Prishtina"	3.12	3.31
7	"7 Shtatori"	3.44	3.07
8	"Abdyl Frashëri"	3.02	3.17
9	"Prenk Jakova"	3.16	3.53
10	"Gjin Gazulli"	3.61	3
11	"Alauddin"	2.88	3.71
12	"Ahmet Gashi"	3.46	3.73
13	"Gjimnazi Matematikor"	4.05	4.1
	Gjithsej	3.54	3.58



Krahasueshmëria e vlerësimit të brendshëm me atë të jashtëm në nivelin e arsimit të mesëm të lartë



PËRFUNDIMI

Bazuar në të dhënat statistikore të prezantuar më lartë, vlerësimet dhe analizës së përgjithshme të realizuar mbi rezultatet e arritura nga nxënësit në tri nivelet e arsimit parauniversitar gjatë vitit shkollor 2015/16, si dhe zhvillimeve të përgjithshme të ecurisë së procesit edukativo-arsimor konstatojmë, se në këtë vit shkollor ka ngritje të kënaqshme të rezultateve dhe suksesit të nxënësve në Komunën e Prishtinës, pra konsiderohet një vit i suksesshëm në raport me suksesin dhe rezultatet e viteve paraprahe.

Kjo është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarra nga Drejtoria e Arsimit, në shumë dimensione në funksion të përmirësimit dhe ngritjen së cilësisë në arsim.

Në nivelin e arsimit fillor (I-V), pas vlerësimit të suksesit dhe rezultateve të lartcekura, arrijmë në përfundim se në këtë nivel të arsimit kemi pasur një zhvillim pozitiv të ngritjes së suksesit të nxënësve prej 0.05-përqind, në krahasim me rezultatet e suksesit të vitit të kaluar.

Por, me theks të veçantë duhet potencuar, se në këtë nivel të arsimit kemi një përmirësim të jashtëzakonshëm të vijueshmërisë së nxënësve, ku në krahasim me vitin paraparak kemi një zhvillim pozitiv, apo 35.21 – përqind më pak mungesa të shënuar nga nxënësit.

Po ashtu, edhe në nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX), duke u bazuar në të dhënat dhe pas analizës së realizuar rezultateve të prezantuara më lartë, arrijmë në përfundim se në këtë nivel ka zhvillim pozitiv në ngritje të suksesit të nxënësve prej 0.03-përqind, në raport me vitin paraparak. Por, në këtë nivel të arsimit sfidë mbetet ende vijueshmëria e nxënësve.

Ndërsa, në bazë të tabelave-grafikoneve të prezantuar, në nivelin e arsimit të mesëm të lartë (X-XII) konstatohet, se në këtë nivel ka një zhvillim pozitiv, si në ngritjen e suksesit të nxënësve, po ashtu edhe në vijueshmërinë e tyre.

Është indikativ fakti, ky trend dhe zhvillim pozitiv që kanë reflektuar në përmirësimin e rezultateve të nxënësve në tri nivelet e arsimit parauniversitar, është si rezultat i masave dhe veprimeve konkrete të ndërmarrë nga Drejtoria e Arsimit në ngritje të cilësisë në shumë segmente si: respektimi i ligjeve dhe Udhëzimit Administrativ mbi numrin maksimal të nxënësve, mbështetje, mbikëqyrje dhe këshillim i vazhdueshëm nga zyrtarët e arsimit, fillimi i implementimit të mësimin me qëndrim tërëditor në tri institucione arsimore, puna e drejtuesve të institucioneve arsimore, mësimdhënësve dhe faktorëve tjerë relevant.

Rezultatet e Testit të Arritshmërisë në nivel komune, në raport me vitin paraparak ka shënuar një ngritje të theksuar të rezultateve prej 8.42-përqind. Po

ashtu, duhet vënë në pah se këtë vit kemi një vlerësim më të përafërt në mes vlerësimit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Ndërsa, provimin shtetëror të maturës në Komunën e Prishtinës e kanë kaluar **90.36**–përqind të nxënësve. Krahasuar me suksesin e vitit paraprak është shënuar një ngritje e kënaqshme e kalueshmërisë prej **7.48-përqind**. Kjo ngritje e kalueshmërisë prej 7.48-përqind është si rezultat i punëve dhe detyrave të realizuar në përmirësimin e cilësisë në institucionet edukativo-arsimore, dhe po ashtu ka reflektuar edhe ulja e kriterit të kalueshmërisë së provimit shtetëror të maturës nga 50% në 40%, sipas Ligjit të ri të maturës.

Megjithatë, duhet cekur se çështje sfiduese për sistemin e arsimit në Republikën e Kosovës mbetet akoma cilësia e vlerësimit, sepse ende nuk kemi një kriter objektiv dhe të standardizuar të vlerësimit të nxënësve në institucionet arsimore. Pra, marrë në tërësi dhe krahasuar edhe me vitet paraprake, konstatojmë se akoma nuk kemi arritur një progres të duhur, drejt standardizimit të procesit të vlerësimit, si një standardizim dhe qëndrueshmëri konstante të arritshmërisë në mësim.

Është indikativ fakti, se ndër faktorët determinues që pengojnë në vlerësimin real dhe objektiv të nxënësve në shkollat e Komunës së Prishtinës, është numri i madh i nxënësve në klasë në disa shkolla të qytetit e sidomos në klasat e formuara më herët, por tani po punohet të mos tejkalohet numri i nxënësve në paralele, duke respektuar standardin e lejuar për klasë. Pra mesatarja e numrit të nxënësve për paralele 23,13 të nivelit fillor dhe 24,83 të mesëm të ulët, është pasojë e numrit jashtëzakonisht të vogël të nxënësve në shkollat e vendbanimeve rurale të Prishtinës, në të cilat shkolla kemi hapësirë të madhe shkollore në krahasim me numrin e nxënësve. E kundërt është gjendja në shkollat e qytetit, ku kemi numër të madh të nxënësve dhe hapësirë jo të mjaftueshme shkollore. Kjo është si rezultat i lëvizjeve demografike fshat-qytet, sidomos në vitet e fundit, statistikisht tregojnë se shkollat fillore dhe të mesme të ulëta, në zona rurale dhe urbane nuk janë të populluara njëtrajtësisht, ku shkollat e qytetit janë të mbingarkuara, kurse disa shkolla në zona rurale janë gjysmë të zbrazëta.

Për të konstatuar ecurinë dhe zhvillimet në arsim Drejtoria e Arsimit në fund të vitit shkollor 2015/16, ka realizuar një analizë të përgjithshme suksesit dhe rezultateve të nxënësve të arritur për secilën lëndë dhe krahasimin me rezultatet e vlerësimit të jashtëm. Nga analiza e realizuar konstatohet, se nga vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm në nivelin e mesëm të ulët ka shënuar një përafrim të rezultateve, ndërsa në nivelin e mesëm të lartë ka një dallim më të theksuar në vlerësim.

Është sinjifikativ fakti se mbikëqyrja pedagogjike dhe profesionale e shkollave që nga viti 2000 e këndeje, prej se u shuan entet pedagogjike, është pika më e

dobët e sistemit arsimor në Republikën e Kosovës, ndonëse në vitet e fundit janë bërë disa përpjekje për riaktivizimin edhe të Inspektoratit arsimor (MASHT), por ai ende është shumë larg nevojave dhe kërkesave.

Edhe pse me Ligjin për Arsimin në Komunat e Republikës së Kosovës, komunave u është lënë në kompetencë mbikëqyrja e procesit arsimor në pajtim me udhëzimet e përcaktuar nga MASHT-i, komunat nuk kanë arritur të krijojnë mekanizmat e nevojshme dhe ta rrisin numrin e zyrtarëve në atë mënyrë që të krijojnë ekipe profesionale që të bëjnë mbikëqyrjen e procesit arsimor. Në këtë segment ka ende kompetenca jo të qarta dhe të përziera.

Të gjithë këta faktorë të lartcekur e pamundësojnë një vlerësim real dhe objektiv të nxënësve dhe ndikojnë drejtpërdrejt në arritshmërinë e nxënësve.

Fakt shqetësues në shkollat e komunës së Prishtinës, mbetet ende numri i madh i mungesave të nxënësve në të tri nivelet e arsimit parauniversitar, por me theks të veçantë janë mungesat e nxënësve të nivelit të tretë **X-XII**, ky numër i madh i mungesave sigurisht që reflekton edhe në suksesin e nxënësve. Në këtë segment kërkohet një angazhim dhe punë më e madhe nga drejtorët e shkollave, kujdestarët e klasave, prindërve dhe të gjithë faktorët relevantë në mënyrë që të përmirësohet vijueshmëria e nxënësve në mësim. Kuvendi Komunal i Prishtinës, tani ka aprovuar Rregulloren e punës së shkollave, që mendojmë se do të ndikoi edhe në këtë drejtim.

Po ashtu, një sfidë imediate në shkollat e Prishtinës, ashtu si edhe të gjithë Republikës së Kosovës është mungesa e një shërbimit profesional, për vlerësimin e performancës së mësimdhënësve në punën e tyre edukativo-arsimore. Vlen të përmendet se sado që Drejtoria e Arsimit ka planifikuar nga viti i kaluar në bashkëpunim me Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe organizata ndërkombëtare që merren me çështjen e cilësisë në arsim të fillojnë vlerësimin e performancës së mësimdhënësve në lëndë të caktuara, ka pasur rezistencë dhe mosgatishmëri për këtë proces.

Drejtoria komunale po punon në vazhdimësi me të gjithë kapacitetin maksimal, duke bashkëpunuar edhe me institucionet relevante përgjegjëse të arsimit, që në Komunën e Prishtinës të ndërtohet një infrastrukturë shkollore e nivelit bashkëkohor, duke krijuar kushte optimale që në shkollat tona, të ngritët cilësia në mësim dhe në veçanti të përmirësohen praktikat vlerësuese të nxënësve si dhe për avancimin e arsimit në shkollat e Komunës së Prishtinës, me qëllim që shkollat tona të arrijnë në stadin e shkollave të përparuara në aspektin zhvillimor.

REKOMANDIME:

- 1. Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm, duhet të ngrihet në nivelin e standardit të meritës;**
- 2. Vlerësimi i performancës së stafit edukativo-arsimor;**
- 3. Të përgatiten udhëzues dhe doracak për përdorimin e standardeve në arsim dhe zbatimin e kriterëve të vlerësimit, si dhe aftësimi i mësimitdhënësve dhe drejtuesve të shkollave në fushën e vlerësimit të nxënësve , vlerësimit të performancës së shkollës dhe vetëvlerësimit;**
- 4. Të rishiqohet forma dhe organizimi i Testit të Arritshmërisë nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë**
- 5. Të kriteri i regjistrimit të nxënësve në klasë të dhjetë (X), të rishikohen përqindja e pikëve të Testit të Arritshmërisë;**
- 6. Testet e provimit shtetëror të maturës, të përgatiten sipas profileve dhe plan-programeve që zhvillojnë shkollat e ndryshme, e të ndryshohet forma e organizimit ;**
- 7. Të shtohen kompetencat dhe përgjegjësia e shkollës,**
- 8. Të intensifikohet bashkëpunimi me prindër, njoftimi me kohë lidhur me mungesat e nxënësve, zhvillimi i aktiviteteve të përbashkëta me qëllim të avansimit të procesit mësimor, masat disiplinore, fushata dhe aktivitete vetëdijesimi etj;**

